

LIGJ
Nr.7874, datë 17.11.1994

PËR STATUSIN E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE
TË POPULLIT SHQIPTAR

(Ndryshuar me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; nr. 8664, datë 18.9.2000; nr.9568, datë 19.6.2006; nr.9724, datë 3.5.2007, nr. 67/2019, datë 3.10.2019)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(Ndryshuar titulli i ligjit me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusi i veteranit të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, që më poshtë do të quhet “Status”, përcakton kriteret që një person të njihet veteran i kësaj lufte, si dhe të drejtat që fitohen nga ky status.

Neni 2

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e përfitojnë shtetasit shqiptarë e të huaj, që kanë marrë pjesë me armë në dorë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve nazifashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, që nga 7 prilli i vitit 1939 deri më 29 nëntor 1944; luftëtarët e inkuadruar në ato njësi të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, që luftuan jashtë kufijve tanë shtetërore deri më 9 maj 1945; ata që kanë zhvilluar veprimtari të organizuar antifashiste nacionalçlirimtare në ilegalitet, në prapavijë të armikut e në zonat e çliruara; kryefamiljarët e atëhershëm të familjeve të njohura si baza të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; të burgosurit antifashistë dhe të internuarit në burgjet dhe në kampet nazifashiste brenda dhe jashtë vendit, si dhe shtetasit shqiptarë, që kanë marrë pjesë aktive në luftë kundër nazifashizmit në vende të tjera.

Neni 3

(Ndryshuar shkronja “d” me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; shtuar paragraf në shkronjën “dh” me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; shtuar shkronja “e” me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Qenia veteran i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar vërtetohet me njërin prej këtyre dokumenteve:

- a) Librezën e pensionit, ku tregohet shtesa prej 100 lekësh në muaj për pjesëmarrje në luftë.
 - b) Dokumentin që vërteton zotërimin të paktën të një dekorate të Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.
 - c) Vërtetimin e degës ushtarake të rrethit, të Ministrisë së Mbrojtjes ose të Ministrisë së Rendit për pjesëmarrjen në Luftën kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar.
 - ç) Vendimin e ish-komiteteve ekzekutive të rretheve, me të cilin veteranit i është njohur dyfishi i kohës së luftës për vjetërsi në punë.
 - d) Me çdo dokument tjetër zyrtar, me burim arkivor të referuar qartë, i cili vërteton pjesëmarrjen në Luftën a në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare.
- Të tilla vlerësohen edhe dokumentet e lëshuara nga arkivat shtetërore të rretheve dhe të institucioneve shtetërore, në bazë të të dhënave të dosjeve personale që kanë në ruajtje.
- dh) Për ata që veprimtarinë e tyre kundër pushtuesve nazifashistë e kanë kryer jashtë vendit, për

njohjen e statusit vlen dokumentacioni i njëjtë, i marrë nga shteti i huaj.

Për raste të veçanta, kur ka mungesa objektive, vendos Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

e) Plagosja, për efekt të statusit të veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, mund të vërtetohet edhe me vërtetim të komisionit të spitalit qendror të ushtrisë dhe me një dokument të arkivave shtetërore (ose me tri deklaratë të bashkëluftëtarëve për rrethanat e plagosjes).

Kur mungojnë dokumentet e kërkuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, pjesëmarrja në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe qenia veteran i saj mund të vërtetohen me vendimin e Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Për të vërtetuar pjesëmarrjen e organizuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, Komisioni Qendror i Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare mund të shqyrtojë dhe të vlerësojë dokumente të bazuara në historikun e fshatit, të qytetit ose të formacionit partizan, të miratuar nga komisionet e posaçme të ngritura para vitit 1994, të lëshuara nga muzeu historik i rrethit ose nga organi drejtues i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në shkallë rrethi e lart, në të dhënat historiografike ose të medias së shkruar të botuara para datës 31 dhjetor 1993, në dokumentet personale si librezë ushtarake, librezë të punës, çertifikatë anëtarësie në një organizatë politiko-shoqërore, në “dëshminë e partizanit”, në të dhënat arkivore zyrtare, në dëshmitë personale nga bashkëluftëtarët, bashkëpunëtorët ose bashkëvuajtësit e kohës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Neni 4

(Shtuar paragraf pas paragrafit të fundit me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Kërkesa dhe dokumenti vërtetues i paraqiten komisionit përkatës të ngritur në çdo rreth me vendim të Këshillit të Ministrave sipas propozimit të Ministrisë së Mbrojtjes. Dokumentet përkatëse, së bashku me mendimin e tij, komisioni i rrethit ia paraqet Ministrisë së Mbrojtjes, e cila, pas shqyrtimit të nevojshëm, vendos për njohjen ose jo të qënies veteran, me përjashtim të përcaktimit të gërmës “a” të nenit 3, të cilat nuk janë objekt rishikimi. Veterani pajiset me dokumentin përkatës, të emërtuar “Libreza e veteranit”. Dokumenti përmban identitetin e plotë dhe fotografinë e veteranit.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

Kur kërkuar që nuk i është drejtuar gjykatës, pas vendimit të Komisionit Qendror, paraqet disa dokumente të reja, dosja e tij rishqyrtohet nga ky komision. Të drejtën e rishqyrtimit e kanë edhe kërkesat e pashqyrtuara të veteranëve të depozituara pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 5

Me vdekjen e veteranit librezë i dorëzohet organit që e ka lëshuar atë. Familjes i jepet një dokument që vërteton se është familje veterani.

Neni 6

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999)

Statusi i veteranit nuk u njihet ose u hiqet personave që janë dënuar ose dënohen me vendim gjykatë të formës së prerë, për krime lufte, për bashkëpunim me pushtuesit nazifashistë ose për veprimtari agjenturore kundër interesave të atdheut.

Neni 7

(shtuar një paragraf me ligjin nr. 67/2019, datë 3.10.2019)

Veterani i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë, si figurë e lartë e popullit dhe e atdheut, gëzon mbrojtje të veçantë ligjore.

Dita e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar është data 20 korrik.

Neni 8

(Shtuar fjali në fund të paragrafit të parë me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; shfuqizuar paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit me ligjin nr.9568, datë 19.6.2006)

Këshilli i Ministrave cakton një shpërblim mujor për personat që gëzojnë statusin e veteranit, për ata që gëzojnë statusin e invalidit të luftës, si dhe për të internuarit në kampet e përqendrimit nazifashist. Veteranëve të plagosur në Luftën kundër pushtuesve nazifashistë që nuk përfitojnë statusin e invalidit të luftës, u jepet një shpërblim plus mbi atë të veteranit në masën që cakton Këshilli i Ministrave. Të internuarve në kampet e përqendrimit nazifashist, përveç shpërblimit të veteranit, u jepet plus shpërblimi i invalidit të luftës të grupit të parë. Një shpërblim shtesë jepet për të burgosurit politikë antifashistë.

Masa e shpërblimit ndryshohet në varësi nga indeksi i çmimeve dhe inflacionit.

Neni 9

(Shtuar paragrafë me ligjin nr.8526, datë 23.9.1999; ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9724, datë 3.5.2007)

Veteranët gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitalet, klinikat dentare dhe qendrat e kurimit që financohen nga shteti, si dhe përfitojnë falas barnat për sëmundje kronike, sipas kritereve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Shteti financoon organizatat e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe organizatat e tjera të veteranëve të kësaj lufte.

Masa vjetore e financimit përcaktohet në Buxhetin e Shtetit. Ministria e Mbrojtjes bën ndarjen e fondit për çdo organizatë veteranësh, bazuar në numrin e anëtarësisë dhe planin vjetor të veprimtarive, të planifikuara nga këto organizata në fillim të çdo viti.

Neni 10

Veteranëve u sigurohet falas udhëtimi me mjetet e komunikacionit urban shtetëror, kurse udhëtimi interurban shtetëror me gjysmë çmimi. Për këtë si dokument provues shërben librezja e veteranit.

Neni 11

Organet e pushtetit lokal duhet t'u japin përparësi zgjidhjes së kërkesave të veteranëve për strehim, duke mbajtur parasysh kushtet, veçoritë dhe gjendjen shëndetësore të tyre.

Neni 12

Veteranët gëzojnë të drejtën e pushimit në shtëpitë e pushimit të punonjësve dhe ushtarakëve, sipas çmimit dhe kohës së caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 13

Veteranët e Luftës kundër pushtuesve nazifashistë nuk paguajnë asnjë lloj takse të drejtpërdrejtë.

Neni 14

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Këshilli i Ministrave.

Neni 15

Çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.962, datë 22.11.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha.**

